

**STATUTI & AKT THEMLIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**  
**"E.A.L.CONCEPT HOLDING" SH.P.K**

**Neni 1**

**Emërtimi i shoqërisë**

Sot më datë 23/09/2024 krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **E.A.L.CONCEPT HOLDING** shpk nga ortaket Everest Troka shqiptar i datëlindjes 07.12.1988 me mjet identifikimi I81207065D Enver Ahmetxhekaj Belg me mjet idnetifikimi GA9753642 me përgjegjësi të plotë e juridike për të vepruar. Shoqëria është person juridik dhe ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare".

**Neni 2**

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë **"E.A.L.CONCEPT HOLDING"** shpk është Tirane Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Vaso Pasha, Nr.325. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filile dege dhe shoqeri te tjera.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin tregtar do të jetë subjekt i të drejtës me një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut të shoqerisë.

**Neni 4**

**Objekti**

Objekti i shoqërisë do të jetë si vijon: Ndërtime civile, energjitetike, industriale, turistike, Bujqesore etj, shumekateshe dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Ndertim i rrugeve dhe mirembajtje e tyre. Ndertim i veprave te artit ( ura, tunele ). Punime dhei, sistemime, tarracime etj. Punime carpenterie. Prodhimet dhe perpunime materiale inerte etj. Rikonstruksione ndertesash dhe restaurim te çdo lloji monumenti. Mirembajtje e qendrave historike muzeale, parqeve etj. Sherbime pastrimi. Mirembajtje dhe zhvillim dekor i per qytetet. Instalime elektrike, hidraulike, telefonie, fibra optike, interneti etj. Studime urbanistike.

Projektim ndertimesh civile, industriale, turistike, ekonomike, bujquesore shumekateshe. Projekte urbane. Sherbime supervizimi ne çdo kategori ndertimesh. Kolaudim te çdo lloji kategorie ndertimi. Ndertim i qendrave tregetare. Import-eksport dhe tregetimme shumice e pakice te produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysem te gatshme. Import-eksport i pijeve alkoolike dhe jo alkoolike si dhe pijeve energjike te te gjitha llojeve. Import-eksport i produkteve ushqimore te te gjitha llojeve, detergjente, produkte industriale etj. Import-eksport te te gjitha llojeve te veshjeve, produkte kozmetike te çdo lloj marke. Import - eksport, tregetim me shumice e pakice I pajisjeve industriale, elektrike, elektrike, telefonike, elektroshtepiak, artikujve te mobilerise etj. Import – eksport dhe tregetim me shumice e pakice i materialeve te ndertimit, brende dhe jashte vendit per llogari te shoqeris apo te treteve. Import - eksport e tregetim i makinerive e pajisjeve, mjeteve motorike, autovetura, kamione, mjete bujquesore e pjese kembimi te tyre. Import - eksport ne fushen e teknologjise, industrine tekstile dhe minerale. Prodhimi dhe perpunimi i materialeve qe perdoren ne ndertim dhe prodhim dhe perpunim i mineraleve. Transport kombtar dhe nderkombtar ne rruge detar, tokesore dhe ajrore. Import - eksport te barnave mjekesore. Import - eksport hidrokarbure. Blerje, shitje, dhenie me qira e pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Gjithashtu per te realizuar objektin e qellimit te saj, shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje çdo lloj aktiviteti me qellim ndertimi, tregetar, financier, qeradhenes apo dorezanes qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te veprimtarise se saj. Sherbime kontabiliteti. Sherbime juridike. Sherbime per menaxhim biznesi. Sherbime bujquesore, kanalizime, pyllezim dhe mirembajtje, sera bujquesore, ullishte, fidanishte, kullota. Ndertim i fermave bujquesore dhe blektorale. Industria e turizmit, fshate turistike, bare, restorante, hotele, resorte. Industria e perpunimit te drurit, mobileri. Industria e modes, design, marka veshjesh. Çdo lloj sherbimi tjeter papermendor.

## NENI 5

### Kapitali i regjistruar

Vlera e kapitalit të kontribuar dhe i regjistruar në shoqëri ështe 800000 leke (teteqind mijë), numri i kuotave eshte 2(dy)i zoteruar 50% nga ortaku Everest Troka me ID I81207065D me një vlerë 400000(katerqind mijë) 1 kuote dhe 50% nga ortaku Enver Ahmetxhekaj me një vlerë 400000 (katerqind mijë) 1 kuote

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogelohet me vendim të Asamblese së përgjithshme të shoqërisë.

## Není 6

### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërise "E.A.LCONCEPT HOLDING "shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit nëkapitalin e shoqërisë;

shitblerjes,

trashëgimisë;

dhurimit

çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen në mbledhjen e asamblese të shoqërisë ku të drejtën e parablerjes e kanë ortakët e shoqërisë

## Neni 7

### Asambleja e Përgjithëshme e shoqërisë

#### Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithëshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c"
- dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë,

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithëshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës
3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
- Neni 8**
- Mbledhja e asamblesë së përgjithshme**
1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.
  2. Asambleja e përgjithëshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
  3. Asambleja e përgjithëshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  4. Asambleja e përgjithëshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  5. Asambleja e përgjithëshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithëshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
  7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte

normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm/asambleja e ortakeve.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithëshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes**

1. Asambleja e përgjithëshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kërkesa nga ortakët e pakicës**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnëtë paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithëshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithëshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithëshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 këtij ligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rezikon të ndikojë në vendimmarjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar

### Neni 11

#### Përfaqësimi në asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithëshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithëshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 12

#### Kuorumi

1. Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithëshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në se ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithëshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 13

#### Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithëshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet etjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithëshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### **Neni 14**

##### **E drejta e votës**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Statuti mund tëparashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesësë përgjithëshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithëshme nga një vendndodhje tjeter,
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithëshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithëshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njilhet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

#### **Neni 15**

##### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithëshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien osejo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

## Neni 16

### Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithëshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithëshme.
- 2. Procesverbali duhet të përbajë datën e vendin embledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithëshme.
- 4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## Neni 17

### Drejtimi dhe administrimit

Shoqëria tregtare "**E.A.L.CONCEPT HOLDING**" shpk do të drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim te Asamblesë të Shoqërisë. Administratori i shoqërisë për periudhën 5 vjeçare duke filluar nga data e sotme do të jetë Everest Troka shqiptar i datëlindjes 07.12.1988 me mjet identifikimi I81207065D. Administratori ka të drejë e të detyrohet të :

- Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politika tregtare të vendosur nga asamblea e përgjithëshme e shoqërisë.
- Përfaqësojë shoqërinë tregtare

- Kujdeset per mbajtjen saktë e të regullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe sëbashku me propozimet propoz për shpërndarjen e fitimeve. I paraqet këto përpara asamblesë së përgjithëshme të shoqërisë për miratim.
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohen e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhenat e detyrueshme siç parashikohen në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
- Raporton para asamblesë të përgjithëshme e shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi te veçantë për veprimtarinë e shoqerisë tregtare,
- Administratori do të shpërblehet sipas përcaktimit të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

### **Neni 18**

#### **Kontrolli i brendshem**

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një ekspert kontabël të regjistruar, i cili është përgjegjës përpara shoqërisë për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në regull e detyrës së tij

### **Neni 19**

#### **Bilancet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqërisë do të mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, perveç rasteve e urdhërave të veçanta të ortakëve të shoqërisë.

Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabël dhe rezultati ekonomik humbje/fitim. Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës dhe pas pagimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim asamblesë së përgjithëshme te shoqërisë.

### **Neni 20**

#### **Shpërbërja e shoqërisë**

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe çfardo shkaku. Në rast shkrirje para afatit të shoqërisë, Asambleja e përgjithëshme e shoqërisë vendos mbi mënyrat e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdator duke i përcaktuar dhe detyrat. Ne rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqerohet nga shënimi "shoqëri në likujdim"

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombetare të Biznesit në perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit "

### Neni 21

#### Dispozitat perfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve nga asambleja e përgjithëshme e shoqërisë.

Shoqeria "E.A.L.CONCEPT HOLDING" shpk do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në perputhje me normat e legjisacionit shqiptar në përgjithësi, normat e këtij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur.

Ky statut nënshkruhet nga ortaku i shoqërisë në datën 23/09/2024

#### Ortaket

Everest Troka



Enver Ahmetxhekaj

